



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 520 Akti

Nr. 407 Vendimi
Tiranë, më 25.6.2021

V E N D I M

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 24.6.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Lutfije Celami**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ligji nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi Znj.Lutfije Celami në seancën dëgjimore, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Znj. Lutfije Celami është subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", znj. Lutfije Celami, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke

u shortuar në datën 15.6.2020, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Xhensila Pine (relatore).

3. Menjëherë me hedhjen e shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016 dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ) sipas ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesuese të tij, komisioneren Firdes Shuli. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqënien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, datë 11.6.2021, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Lutfije Celami, bazuar në tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, dhe nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për marrjen e provave ose thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin kur e ushtrimin mbi këto të drejta.

6. Subjekti i rivlerësimit Lutfije Celami depozitoi shpjegimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës, brenda afatit të përcaktuar dhe ato u administruan dhe analizuan nga trupi gjykues.

7. Trupi gjykues, ftoi subjektin e rivlerësimit Lutfije Celami, në seancën dëgjimore, në datën 24.6.2021, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

I. SEANCA DËGJIMORE

8. Në datën 24.6.2021, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit Lutfije Celami, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtare, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, **Znj. Lutfije Celami**, u paraqit personalisht në seancë, dha shpjegimet e saj, si dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

9. Seanca dëgjimore u ndërpre për të vazhduar në datën 25.6.2021 me shpalljen e vendimit të trupit gjykues.

II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

10. Subjekti i rivlerësimit Lutfije Celami ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit administrativ, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

A.VLERËSIMI I PASURISË

11. ILDKPKI-ja ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar raportin për subjektin Lutfije Celami me konkluzionin:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/1 RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

12. Pavarësisht se sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ILDKPKI-ja është autoriteti përgjegjës për kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë për subjektet e rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017¹, të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni kreu një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke hetuar në mënyrë të pavarur të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

13. Gjendje në llogarinë rrjedhëse në "Raiffeisen Bank"

Burimi i krijimit: kursime nga paga. Vlera: 287.948,79 lekë. Pjesa takuese: 100%.

13.1 Në deklarimin e interesave private para fillimit të detyrës në datën 9.12.2011 deri në DPV-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje në llogarinë bankare apo shtesa/pakësime, ndër vite, por janë deklaruar vetëm të ardhurat nga paga.

13.2. Në DPV-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit në ndryshim të pasurive dhe burim të krijimit, ndër të tjera, deklaroi: "Të ardhurat nga kursimet nga paga sipas gjendjes në llogarinë rrjedhëse shuma 135.304 lekë".

13.3. Në DPV-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit në ndryshim të pasurive dhe burim të krijimit, ndër të tjera, deklaroi: "Të ardhura nga kursimet nga paga sipas gjendjes në llogarinë rrjedhëse shuma 381.293 lekë".

13.4. Në DPV-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit në ndryshim të pasurive dhe burim të krijimit, ndër të tjera, deklaroi: "Kursimet nga paga për vitin 2016, sipas gjendjes në llogarinë bankare rrjedhëse të pagës në datën 31.12.2016, shuma 222.804 lekë".

13.5. Nga hetimi i Komisionit², rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka çelur llogarinë rrjedhëse në lekë nr. 0001419494, në datën 9.10.2009, në "Raiffeisen Bank". Në datën 27.1.2017, gjendja e

¹ 41.Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: "Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit". Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se "procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë". Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse."

²Shkresë me nr. *** prot., datë 24.7.2020 dhe kthim përgjigje nr. *** prot., datë 6.8.2020, nga "Raiffeisen Bank".

kësaj llogarie ka qenë në vlerën 287.949 lekë. Kjo llogari ka pasur këtë ecuri deri në deklaratën *Vetting*.

Viti	Vlera në lekë - gjendje më 31.12.2016
2009	7.125
2010	126
2011	837
2012	31.414
2013	31.417
2014	135.304
2015	381.293
2016	222.804
27.1.2017	287.949

14. Analizë e burimit të deklaruar të të ardhurave për krijimin/shtimin e vlerave monetare në këtë depozitë dhe mundësia financiare

14.1. Gjatë hetimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar³ se ka jetuar me prindërit dhe familjarë të tjerë deri në fund të vitit 2016, duke paraqitur dokumentacion ligjor për të ardhurat e tyre. Komisioni ka shqyrtuar dokumentacionin e disponuar, për të analizuar mundësinë financiare të familjarëve të subjektit për të mbuluar shpenzimet për konsum jetik si dhe shpenzime të tjera për periudhën 2012 – 2017 (periudhë kjo e ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit).

Konkretisht, për periudhën 2012 – 2016, të ardhurat e dokumentuara të familjarëve paraqiten:

periudha / person	subjekti ⁴ L.C	prot ⁵ H. C	nëna ⁶ S. C	vëllai ⁷ A. C	kunata ⁸ E. C	totali/periudha
2012	850.753	286.272	30.825	2.131.043	406.969	3.705.862
2013	807.288	143.136		2.258.431	392.554	3.601.409
2014	1.084.979	600.608		2.320.483	378.305	4.384.375
2015	1.084.535	731.970		2.356.001	476.532	4.649.038
2016	1.049.482	651.908		2.319.125	620.968	4.641.483
Total 2012-2016	4.877.037	2.413.894	30.825	11.385.083	2.275.328	20.982.167

³Përgjigje të pyetësorit 1 dhe 2.

⁴Vërtetim për pagën *bruto* dhe *neto* deri në datën 22.1.2014 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vërtetim nr. *** prot., datë 13.1.2017, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat.

⁵Vërtetim për trajtim me pagesë kalimtare të ushtarakut në rezervë nr. *** prot., datë 11.1.2019, dorëzuar në përgjigje të pyetësorit nr. 2; të ardhura nga paga dhe shpërblimet për periudhën qershor 2014 – dhjetor 2016 referuar transferimeve në “Credins Bank” nga punëdhënësi “Shoqëritë Huamarrëse në Administrim”.

⁶Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit për periudhën 15.5.2011 – 14.5.2012.

⁷Vërtetim page lëshuar në datën 11.11.2016 nga shoqëria “****” sh.p.k., për periudhën 10.2.2009 – 31.10.2016; të dhëna për pagën *neto* nëntor, dhjetor 2016, transferuar në “OTP Bank”, shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2020; kontratë individuale të punës datë 15.9.2014 dhe datë 12.10.2015, ndërmjet A. C., dhe universitetit “****”, Tiranë; të dhëna nga BKT-ja protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 22.1.2021.

⁸ Referuar të dhënave me shkresë nr. *** prot., datë 5.3.2021, nga “Raiffeisen Bank”.

14.2. Gjithashtu, për periudhën 1.7.2013 – 31.12.2016, babai i subjektit ka përfituar edhe pension ushtarak të parakohshëm⁹ në vlerë 556.447 lekë.

14.3. Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e disponuar, nga Komisioni u vlerësua se personat me të cilët ka bashkëjetuar subjekti për periudhën 2012 – 2016, kanë përfituar të ardhura të dokumentuara, të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve për jetesë për këtë periudhë.

14.4. Në vlerësim të faktit se burimi i të ardhurave të deklaruara nga subjekti për krijim të pasurive prej saj për këtë periudhë, kanë qenë vetëm të ardhurat nga paga, si dhe deklarimi për mospasje të asnjë lloj kontributi në pasuri apo vlera monetare të krijuara nga anëtarët e tjerë të familjes¹⁰, Komisioni vendosi që analiza e treguesve financiarë, për periudhën 2011 – 2016, të kryhet duke marrë në konsideratë vetëm të ardhura, pasuritë dhe shpenzimet vetëm të subjektit të rivlerësimit.

14.5. Subjekti i rivlerësimit, si në deklaratën *Vetting* ashtu edhe në DPV-të përkatëse, si burim për krijimin dhe shtimin e kësaj depozite ka deklaruar të ardhurat nga paga.

14.6. Në lidhje me mundësinë financiare për krijimin/shtesat vjetore në këtë llogari rrjedhëse në lekë në emër të subjektit të rivlerësimit, janë analizuar së bashku me pasuri të tjera të deklaruara të krijuara/blerë për këtë periudhë¹¹, nga analiza paraprake e treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, për periudhën 2012 – 2015, subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për çdo vit për shtesat në vlerat monetare në këtë llogari bankare.

15. Gjendje në depozitën e kursimit, në “Raiffeisen Bank”

Burimi i krijimit: kursime nga paga. Vlera: 195.000 lekë dhe 25.14 lekë. Pjesa takuese: 100%.

15.1. Në DPV-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit në ndryshim të pasurive dhe burim të krijimit, ndër të tjera, deklaron: *“Të ardhura nga depozita bankare pa interes shuma 135.000 lekë”*.

15.2. Në DPV-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit në ndryshim të pasurive dhe burim të krijimit, ndër të tjera, deklaron: *“Të ardhura nga depozita bankare pa interes shuma 195.020 lekë”*.

15.3. Në DPV-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit në ndryshim të pasurive dhe burim të krijimit, ndër të tjera, deklaron: *“Ndryshim të llojit të llogarisë bankare nga llogari rrjedhëse me depozitë me afat njëvjeçar (ndryshuar në datë 15. 4.2016 - 17.4.2017, shuma 195.000 lekë , gjendje në datën 15.4.2016”*.

15.4. Nga hetimi i Komisionit¹², rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka çelur llogarinë depozitë nr. ***, datë 15.0.2014, pranë “Raiffeisen Bank”. Subjekti ka transferuar periodikisht shuma nga llogaria rrjedhëse e pagës dhe, më pas, është mbyllur në depozitë me afat (viti 2016). Në datën 27.1.2017, gjendja e kësaj llogarie depozitë ka qenë në vlerën 195.000 lekë.

15.5. Kjo llogari ka pasur këtë ecuri deri në deklaratën *Vetting*.

Viti	Vlera në lekë - gjendje më 31.12.2016
2014	135.005
2015	195.020
2016	195.000
27.1.2017	195.000

⁹Vërtetim nr. *** prot., datë 30.12.2016, nga DRSSH Tiranë (pjesë e dokumentacionit të dorëzuar me pyetësorin nr. 2).

¹⁰Përgjigje të pyetësorit nr. 2.

¹¹Analiza paraprake e treguesve financiarë i bashkëlidhet këtij materiali si aneks së bashku me shënimet shpjeguese.

¹²Shkresë me nr. *** prot., datë 24.7.2020 dhe kthim përgjigje me nr. *** prot., datë 6.8.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

16. Analizë e burimit të deklaruar të të ardhurave për krijimin/ shtimin e vlerave monetare në këtë depozitë dhe mundësia financiare

16.1. Në lidhje me mundësinë financiare për krijimin/shtesat vjetore në këtë llogari depozitë në lekë në emër të subjektit të rivlerësimit, janë analizuar së bashku me pasuri të tjera të deklaruara të krijuara/ blerë për këto periudha.

16.2 Referuar analizës financiare trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për likuiditetet në depozitën e kursimit, në “Raiffeisen Bank”

17. Automjet “ TOYOTA RAV 4”.

Burimi i krijimit: kursime nga paga. Vlera: 470.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

17.1. Në DPV-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit në ndryshim të pasurive dhe burim të krijimit, ndër të tjera, deklaron: *“Blerje të një automjeti tip “Toyota RAV 4” me targë ***, vit prodhimi 2004, sipas kontratës së shitjes, datë 3.3.2016, me burim të krijimit kursimet nga paga ime gjatë viteve sipas tërheqjes në datën 2.3.2016, në llogarinë bankare rrjedhëse të pagesë shuma 470.000 lekë”.*

17.2. Nga hetimi i Komisionit¹³ ka rezultuar se DPSHTRr-ja konfirmon pronësinë e këtij automjeti në emër të subjektit të rivlerësimit. Nga administrimi i dokumentacionit rezultoi se në datën 3.3.2016 është lidhur kontrata e shitjes midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit me objekt shitjen e automjetit tip “Toyota Rav 4”, ngjyrë gri, kundrejt çmimit 470.000 lekë. Automjeti është porositur dhe blerë nga shitësi shoqëria “****” sh.p.k., në vlerën 2.000 euro, datë 3.2.2016, ndërsa me “DAV, R10507”, datë 5.2.2016, janë shlyer detyrimet doganore në shumën 69.225 lekë.

18. Analizë e burimit të deklaruar të të ardhurave për blerjen/krijimin e kësaj pasurie dhe mundësia financiare

18.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhurat nga paga, si burim për blerjen e kësaj pasurie”.*

18.2. Në DPV-në e vitit 2016, deklarohet i njëjti burim, por janë analizuar edhe veprimet e kryera në llogarinë e pagës pranë “Raiffeisen Bank”, konkretisht: *“Pakësim mbi kursimet nga paga sipas tërheqjes në llogarinë bankare rrjedhëse të pagës në datën 2.3.2016, për blerjen e automjetit tip ‘Toyota RAV 4’, dhe për blerjen e dokumenteve të automjetit (shuma 470.000 lekë +30.000 lekë për dokumentet)”.*

18.3. Për efekt të kohës së pagesës së çmimit të blerjes së kësaj pasurie, Komisioni iu referua faturës tatimore nr. ***, datë 3.3.2016.

18.4. Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank”, rezulton se nga llogaria në lekë e pagës nr. ***, në emër të subjektit në këtë bankë në datën 2.3.2016 është tërhequr *cash* pa përshkrim, shuma 500.000 lekë. Gjendja e kësaj llogarie pas tërheqjes mbetet në vlerën 23.068 lekë.

18.5. Në vlerësim të faktit se subjekti ka deklaruar vetëm të ardhurat e saj nga paga, si burim për blerjen e kësaj pasurie, Komisioni bazuar në të dhënat e vetëdeklaruara/provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, si edhe informacionin/dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, kreu analizën e treguesve financiarë, për periudhën 1.1.2016 – 3.3.2016,

¹³Shkresë nr. *** prot., datë 24.7.2020 dhe kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.8.2020.

për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit, për blerjen e automjetit tip “Toyota Rav 4”, në datën 3.3.2016, në shumën 470.000 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për këtë periudhë, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Analiza e treguesve financiarë periudha 1.1.2016 – 3.3.2016	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga paga dhe shpërblime subjekti i rivlerësimit për periudhën në “Raiffeisen Bank”	273.400
Total të ardhura /të hyra financiare	273.400
Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi Maqedoni në shkurt 2016 deklaruar 120 euro	16.228
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën vetëm subjekti	39.182
Total shpenzime/të dala financiare	55.410
Ndryshim mj. monetare cash deklaruar/llogaritur gj. fillim-gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	358.000
Mjete monetare të disponueshme (1)	575.990
Blerje autoveturë “Toyota RAV 4”, datë 3.3.2016, në shumën 470.000 lekë	470.000
Detyrime	0
Pasuri <i>neto</i> (2)	470.000
Balanca e fondeve (1-2)	105.990

18.6. Referuar analizës financiare trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit tip “Toyota RAV 4”.

19. Gjendje *cash* në vlerën 50.000 lekë

Burimi i krijimit: kursime nga paga gjatë vitit 2016. Vlera: 50.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

19.1. Në deklarin e interesave private para fillimit të detyrës në datën 9.12.2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: **“Gjithsej shumë 200.000 lekë gjendje *cash*...”**.

19.2. Në DPV0në e vitit 2011, subjekti nuk deklaron ndryshime të interesave private më pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme

19.3. Në DPV-në e vitit 2012, subjekti nuk deklaron ndryshim të pasurive dhe burim të krijimit.

19.4. Në DPV-në e vitit 2013, subjekti nuk deklaron ndryshim të pasurive dhe burim të krijimit.

19.5. Në DPV-në e vitit 2014, subjekti nuk deklaron shtesa/pakësime të gjendjes *cash* në banesë

19.6. Në DPV-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit në ndryshim të pasurive dhe burim të krijimit, ndër të tjera, deklaron: **“Të ardhura nga kursimet nga paga (në *cash*) shuma 100.000 lekë”**.

19.7. Në DPV-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit në ndryshim të pasurive dhe burim të krijimit, ndër të tjera, deklaron: **“Kursime nga paga ime gjatë vitit 2016 (në *cash*) shuma 50.000 lekë”**.

19.8. Referuar deklarimeve periodike vjetore të subjektit, gjendja e likuiditeteve *cash* të akumuluar në datën 31.12.2016, rezulton në vlerën 350.000 lekë (në asnjë vit nuk deklaron

pakësim të gjendjeve cash në banesë). Në lidhje me shumën e deklaruar gjendje në deklaratën *Vetting* në datën 27.1.2017 (50.000 lekë), duket se ka mospërputhje ose është konsumuar shuma 300.000 lekë nga gjendja *cash* e deklaruar e akumuluar.

19.9. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ju kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, lidhur me mospërputhje të likuiditeteve të deklaruara gjendje në *cash* në deklaratën *Vetting* me ecurinë e tyre referuar deklarimeve periodike vjetore.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

19.10. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e tij, shpjegon se: *“Referuar deklaratës së interesave private para fillimit të detyrës në datën 9.12.2011, unë kam deklaruar si të ardhura të akumuluar, ndër vite, ndër të tjera, shumën prej 200.000 (dy qind mijë) lekësh gjendje cash. Gjithashtu, referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2015 kam deklaruar si kursime në gjendje cash, shumën prej 100.000 (njëqind mijë) lekësh, ndërsa në deklaratën vjetore të vitit 2016 kam deklaruar si kursime shumën prej 50.000 lekësh. Po ashtu, në deklaratën *Vetting*, në datën 27.1.2017, kam deklaruar si kursime në gjendje cash shumën prej 50.000 lekësh.*

Sqaroj se në lidhje me konstatimin nga ana e Komisionit mbi likuiditetet në gjendje cash të deklaruara nga ana ime në deklaratat e pasurisë si më lart, sqaroj se:

Shuma prej 200.000 lekësh e deklaruar si kursime në fund të vitit 2011, shumë e cila ka pasur si burim të ardhurat, ndër vite, nga punësimi im para fillimit të detyrës, është shpenzuar për nevoja të ndryshme të miat përgjatë vitit 2012. Këtë shumë unë nuk e kam deklaruar si gjendje cash në deklaratën vjetore periodike të vitit 2011, pasi kam menduar se nuk ka qenë e nevojshme për ta deklaruar, meqenëse e kisha deklaruar atë si shumë në deklaratën fillestare të cilën e kam plotësuar në fund të vitit 2011.

*Po ashtu, edhe gjendja cash e deklaruar si kursim në DVP-një e vitit 2015 në shumën prej 100.000 lekësh është shpenzuar për nevoja të ndryshme të miat përgjatë vitit 2016. Gjithashtu, shpjegoj se në DVP-në e vitit 2016 kam deklaruar si kursime në gjendje cash shumën prej 50.000 lekësh si kursime nga paga ime gjatë vitit 2016. Po ashtu, të njëjtën shumë që kam pasur në fund të vitit 2016 në gjendje cash kam patur edhe në datën 27.1.2017, datë në të cilën është plotësuar deklarata *Vetting*, dhe në këtë mënyrë kam pasqyruar të njëjtën vlerë si kursime në gjendje cash.*

Sqaroj se shuma prej 300.000 lekësh, që rezulton nga shuma prej 200.000 lekësh deklaruar si kursime para fillimit të detyrës dhe shumës prej 100.000 lekë deklaruar si kursime cash në DVP-në e vitit 2015, nuk është pasqyruar nga ana ime si pakësim të pasurisë në deklaratat vjetore periodike përkatëse. Mosdeklarimi i kësaj shume si pakësim në DVP përkatëse ka ardhur nga mospasja e njohurive të duhura për mënyrën se si duhej të deklarohet mbi gjendjen cash, pasi kam menduar që duhej të pasqyroja vetëm gjendjen cash, pra sa para cash kisha në fund të vitit, si dhe për faktin që këto shuma nuk janë shpenzuar për të krijuar ndonjë pasuri apo për ndonjë shpenzim që do të duhej ta deklarohet sipas ligjit”.

Komisioni, pasi u njoh me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, vlerëson se pasaktësitë e deklarimit të gjendjeve *cash*, nuk përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit, referuar faktit të rezultuar nga analiza financiare se subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* prej saj pavarësisht pasaktësisë së deklarimeve.

20. Analizë e burimit të deklaruar të të ardhurave për blerjen/krijimin e likuiditeteve gjendje *cash* në banesë dhe mundësia financiare

20.1. Në deklarinimin e interesave private para fillimit të detyrës në datën 9.12.2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të gjendjes *cash* në vlerën 200.000 lekë: (i) të ardhurat nga paga vjetore e marrë, ndër vite, gjatë punësimit në institucione shtetërore, në administratën gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga 2004-2005; (ii) të ardhurat nga paga vjetore gjatë punësimit në Gjykatën e Krimeve të Rënda nga 2006-2008; (iii) gjatë punësimit në ZQRPP-në Tiranë, në vitin 2009; si dhe (iv) të ardhura nga bursa e marrë nga Shkolla e Magjistraturës nga janar 2011 – në shtator 2011.

20.2. Gjithashtu, në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar edhe një hua dhënë vëllait në shumën 200.000 lekë (pa burim të deklaruar të të ardhurave) .

20.3. Lidhur me këtë huadhënie, nëse është kthyer nga vëllai i subjektit kjo shumë e deklaruar, koha e kthimit dhe destinacioni i shumës, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, deklaroi se: “...kjo shumë që i është dhënë vëllait tim, është konsideruar si e falur nga ana ime, për shkak të lidhjes familjare dhe faktit që kemi vazhduar të jetojmë për shumë kohë me njëri tjetrin. Kjo ka qenë edhe arsye se përse unë nuk e kam deklaruar atë në deklaratat përkatëse në vijim..”.

20.4. Mbështetur në dokumentacionin e disponuar, si dhe deklarinimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë, për të verifikuar mundësinë financiare të subjektit për kursimin e shumës në *cash*, dhënien e huas vëllait, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara deri në datën 10.11.2011.

Analiza e treguesve financiarë periudha 11/2002-10/11/2011	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhura <i>neto</i> nga punësimi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë	135.204
Të ardhura <i>neto</i> nga punësimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë	279.254
Të ardhura <i>neto</i> nga punësimi si sekretare në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda	774.499
Të ardhura <i>neto</i> nga punësimi si specialiste në ZQRPP	817.875
Të ardhura/bursë nga Shkolla e Magjistraturës	1.020.000
Total të ardhura /të hyra financiare	3.026.832
Shpenzime udhëtimi/qëndrimi jashtë vendit qershor 2010	52.733
Huadhënie vëllait	200.000
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën vetëm për subjektin	1.073.165
Total shpenzime/të dala financiare	1.325.898
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim-gj. fund periudhe	-200.000
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	74.042
Mjete monetare të disponueshme	1.574.976

20.5. Referuar analizës financiare trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për kursimin e shumës prej 200.000 lekësh në likuiditet *cash* në banesë dhe ka pasur mundësi financiare për kursimin e shumës prej 200.000 lekësh dhënë hua vëllait.

PERSONAT E LIDHUR

21. Personat e lidhur me subjektin sipas deklaratës *Vetting*, prindërit subjektit H. C. (babai) dhe S. C. (nëna) kanë deklaruar të njëjtën pasuri në pjesë takuese nga 50% secili për shkak të regjimit të bashkëpronësisë pasurinë:

21.1. Apartament banimi me sip. 90.30 m², nr. pasurie *, z. k. ***, në Bulevardin ***, Tiranë**, blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 8.4.2013, me shitësit shoqëritë “***” sh.p.k., “***” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. dhe blerësit H. C. në zbatim të kontratës së sipërmarrjes mes sipërmarrësit “****” sh.p.k. dhe porositësit H. C., datë 12.3.2005. Pagesat janë bërë sipas mandatarëkëtimeve nr. ***, datë 15.2.2005 dhe nr. ***, datë 29.3.2006, si dhe pagesa përfundimtare për likuidimin e apartamentit në datën 14.12.2006, sipas fletës bankare të “Tirana Bank”, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., duke u marrë apartamenti në dorëzim në datën 14.12.2006. Vlera: 5.000.000 lekë. Bashkëpronësi me bashkëshorten në pjesë të papërcaktuara sipas regjimit martesor të bashkësisë ligjore.

21.2. Burimi i krijimit: shitblerje apartamenti në Burrel, sipas kontratës së datës 17.7.2002, nëpërmjet shitësit H. C. dhe blerësit F. R.. Kredi bankare për apartament, datë 4.12.2006, me kohëzgjatje 15 vjet, në shumën 20.000 euro, ku 15.000 euro janë përdorur për blerjen e apartamentit dhe 4.800 euro për mobilim. Kredia është shlyer në datën 4.3.2013. Të ardhurat nga paga (apo nga trajtimet të tjera) sipas ligjit, si dhe ato të pjesëtarëve të tjerë të familjes, ndër vite, konkretisht bashkëshortes, djalit dhe vajzave Lutfije dhe E. Celami (kjo e fundit deri në vitin 2010).

21.3. Në datë 8.4.2013 është lidhur kontrata e shitblerjes nr. ***, me objekt shitjen e apartamentit me nr. pasurie ***, vol. ***, f. *** i ndodhur në z. k. ***, ap. ***, k. ***, shk. ***, të objektit “godinë banimi dhe shërbimi 2-9-10 dhe 12 kate +2 kate nëntokë, ndodhur pranë blv. “****”. Referuar vërtetimit nga dokumentet hipotekorë¹⁴ vërtetohet se në regjistrin hipotekor me nr. ***, datë 1.8.2012, figuron i regjistruar apartamenti në pronësi të shoqërive “****” sh.p.k., “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. Apartamenti është marrë në dorëzim sipas aktit të marrjes në dorëzim, datë 14.12.2006, të nënshkruar nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe babait të subjektit të rivlerësimit. Sipas certifikatës së pronësisë¹⁵ lëshuar në datën 16.2.2015 dhe kartelës së pasurisë¹⁶ vërtetohet se pasuria apartament është e regjistruar në emër të babait të subjektit në datën 16.2.2015.

21.4. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1¹⁷, në lidhje me adresat e banimit që nga momenti i marrjes së detyrës për herë të parë, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Në momentin që kam marrë detyrën (datë 10.11.2011) kam qenë me banim në apartamentin e prindërve të mi, apartament, i cili ndodhet në adresën: Njësia Administrative Nr. ***, Rr. “****”, Pallati “****”, ap. ***, Bashkia Tiranë, adresë e deklaruar edhe në deklaratat e pasurisë... apartamenti në të cilën kam banuar deri në kohën kur kam filluar të jetoj me bashkëshortin tim, është në pronësi të prindërve të mi. Kjo e provuar në bazë të kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 8.4.2013, me shitës: shoqëritë “****” sh.p.k., “****” sh.p.k., dhe “****” sh.p.k., dhe blerësi*

¹⁴Dokumentacion në dosjen e ILKPKI-së.

¹⁵Dokumentacion në dosjen e ILKPKI-së.

¹⁶Referuar shkresës kthim përgjigje me nr. *** prot., datë 29.4.2018, të ZVRPP-së Tiranë, gjendur në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁷Përgjigje të pyetjes nr. 1.

*H. C., kontratë e realizuar në zbatim të kontratës së sipërmarrjes mes sipërmarrësit ‘***’ sh.p.k., dhe porositësit H. C., duke u marrë në dorëzim apartamenti sipas akt marrjes në dorëzim, datë 14.12.2006”.*

22. Lidhur me çmimin dhe mënyrën e shlyerjes

22.1. Referuar kontratës së shitblerjes së datës 8.4.2013 së pasurisë (neni 3) është përcaktuar çmimi në shumën 5.000.000 lekë , çmim i cili sipas kësaj kontrate është likuiduar më përpara.

22.2. I është kërkuar subjektit të rivlerësimit, koha e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes së deklaruar sa më sipër mes sipërmarrësit dhe porositësit H. C., si dhe parashikimi i kësteve të pagesës në këtë kontratë.

22.3. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit shpjegon se: *“Kontrata e sipërmarrjes për apartamentin e blerë nga babai im H. C. me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 8.4.2013, nuk disponohet nga ana jonë pasi ka kaluar një kohë e gjatë nga nënshkrimi i saj, por nga çfarë mban mend babai nisur edhe mandatarkëtimet, ajo mund të jetë lidhur në muajt e parë të vitit 2005. Për këtë arsye përshkrimin e kësteve të pagesës së vlerës së objektit që kanë qenë parashikuar në kontratën e sipërmarrjes po e bëjmë duke pasur parasysh mandatarkëtimet dhe fletë bankare ‘nxjerrje llogarie’ që disponojmë, me të cilat provohen pagesat që i janë bërë shoqërisë sipërmarrëse ‘***’ sh.p.k. në kuadër të vlerës së apartamentit...”*

*Këto këste pagese janë kryer prej porositësit H. C. (babait tim), ku dy këste janë paguar dorazi dhe kësti i tretë me kredi me anë të bankës. Konkretisht, këto fakte provohen me: me mandat arkëtimin me nr. ***, datë 15.2.2005, në shumën prej 20.000 euro euro, këst i paguar dorazi; me mandatarkëtimin e dytë me nr. ***, datë 29.3.2006, në shumën prej 672.500 lekësh, këst i paguar dorazi; dhe kësti i tretë prej 15.000 euro është paguar në datën 14.12.2006 me kredi me anë të bankës, siç përshkruhet në fletën bankare ‘nxjerrje llogarie’, ‘likuidim përfundimtar për blerje banese, datë 14.12.2006’.*

*Pra, likuidimi total i vlerës së objektit të apartamentit është paguar nga porositësi H. C. (babai im) në datën 14.12.2006 (data e marrjes në dorëzim të apartamentit sipas akt marrjes në dorëzim datë 14.12.2006) duke mos pasur pas kësaj date asnjë detyrim tjetër në lidhje me vlerën e objektit. Dhe vetëm për efekt të realizimit të veprimeve në regjistrat e pasurive të paluajtshme, për të kryer regjistrimin e këtij apartamenti në emër të babait tim (porositësit-blerësit) H. C., u nënshkrua edhe kontrata e shitjes nr. ***, datë 8.4.2013, me shoqërinë sipërmarrëse. Pra, rezulton se të gjitha detyrimet e porositësit H. C. ndaj shoqërisë sipërmarrëse për vlerën e këtij apartamenti, janë mbyllur përpara se unë të fitoja konkursin e Shkollës së Magjistraturës (vitit 2009).*

*Gjithashtu, evidentojmë faktin se nga ana e babait tim H. C, duke qenë se nuk e dispononim kontratën e sipërmarrjes, i është dërguar kërkesë administratorit të shoqërisë ‘***’ sh.p.k., z. L. Gj., për të na vënë në dispozicion një kopje të kësaj kontrate. Me kthim përgjigjen e kësaj shoqërie, u vumë në dijeni se kjo kontratë nuk disponohet nga sipërmarrësi shoqëria ‘***’ sh.p.k. Nga ana e shoqërisë sipërmarrëse ‘***’ sh.p.k., është konfirmuar vlera e objektit të kontratës dhe mënyra se si është kryer pagesa nga porositësi H. C. (babai im). Gjithashtu, kjo shoqëri ka konfirmuar edhe likuidimin total në kohën para marrjes në dorëzim të apartamentit (dt. 14.12.2006) të vlerës së apartamentit nga ana e porositësit H. C..*

Gjithashtu subjekti i rivlerësimit ka depozituar shkresën kthim përgjigje të shoqërisë “***” sh.p.k., nr. *** prot., datë 25.2.2021, drejtuar porositësit H. C. (babait tim), nëpërmjet së cilës kjo shoqëri informon se: *“Kanë kaluar 15 vjet nga koha që është lidhur kontrata e sipërmarrjes. Kontrata ka*

qenë e thjeshtë dhe pa noter dhe me bërjen e kontratës përfundimtare të shitjes ajo e humbet vlefshmërinë e saj , prandaj dhe nuk është ruajtur...Vlera e objektit të kontratës është 5.000.000 lekë, pagesa e të cilit është bërë cash dhe me bankë para marrjes në dorëzim të apartamentit”.

22.4. Lidhur me shlyerjen e çmimit, Komisioni ka administruar dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, sipas të cilit babai i subjektit: në datën 15.2.2005 ka paguar shumën 20.000 euro (2.534.000 lekë) shoqërisë “****” sh.p.k., sipas mandatarkëtimit nr. ***; në datën 29.3.2006 ka paguar shumën 672.500 lekë shoqërisë “****” sh.p.k., sipas mandatarkëtimit nr. ***; në datën 14.12.2006 nëpërmjet transfertës bankare të “Tirana Bank” është kaluar nga llogaria e vëllait të subjektit A. C. në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. shuma 15.000 euro me përshkrimin “likuidim përfundimtar blerje banese”.

22.5. I është kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranës për ndonjë rast të mundshëm të konfliktit të interesit nga subjekti i rivlerësimit. Në informacionin e përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁸, nuk identifikohen çështje gjyqësore të regjistruara/shqyrtuara, për periudhën 1.1.2011 – 31.1.2014, me palë ndërgjygjëse shoqëritë dhe/ose ortakët/administratorët e tyre sa më sipër të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit.

23. Lidhur me burimet e krijimit

23.1. Në deklaratën *Vetting*, prindërit e subjektit kanë deklaruar burimet e krijimit si vijon:

i) Shitblerje apartamenti në Burrel sipas kontratës së datës 17.7.2002 nëpërmjet shitësit H. C. dhe blerësit F. R..

23.2. Në datën 17.7.2002 është lidhur kontrata e shitblerjes me nr. ***, midis shitësit H. C. dhe blerësit F. R., sipas së cilës shitësi i shet blerësit apartamentin me sip. 68.35 m² të ndodhur në lagjen “****”, Burrel, regjistruar në z. k. ***, kundrejt çmimit 1.600.000 lekë, çmim i cili sipas kontratës është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

23.3. Zyra vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Burrel, me shkresë nr. *** prot, datë 11.9.2017, informon se shtetasit H. dhe S. C., kanë kryer transaksion shitje në datën 19.7.2002, pasurinë e llojit “apartament” me sipërfaqe 68.35 m², në Burrel, Bashkia Mat.

23.4. Në kartelën e pasurisë pjesë të kësaj shkrese, evidentohet data e regjistrimit të kësaj pasurie në emër të këtyre shtetasve më 11.1.1998, si dhe shuma e paguar prej 12.931 lekësh. Gjithashtu, edhe tatimi mbi të ardhura nga shitja, paguar me mandatpagesën nr. 1601, datë 17.7.2002, në shumën 8.000 lekë, nga z. H. C..

ii) Kredi bankare për apartamentin, datë 4.12.2006, me kohëzgjatje 15 vjet, në shumën 20.000 euro, ku 15.000 euro janë përdorur për blerjen e apartamentit dhe 4.800 euro për mobilim dhe shlyer kredia në datën 4.3.2013.

23.5. Në datë 4.12.2006 është lidhur kontrata e kredisë bankare¹⁹ me nr. ***, midis kredidhënësit “Tirana Bank” dhe kredimarrësit H. dhe A. C. me objekt kreditimin në shumën 20.000 euro, për blerje apartamenti me sip. 91.5 m² të një godinë banimi dhe shërbimi 2-9-10 dhe 12 kate +2 kate nëntokë, ndodhur pranë blv. “****”, që do të ndërtohet nga shoqëria “****” sh.p.k. Kohëzgjatja e kredisë është 15 vjet duke filluar nga data e disburimit të kredisë. Për sigurimin e kësaj kredie është vendosur hipotekë mbi apartamentin me sip. 87 m², me adresë rruga “****”, k. ***, shk. ***,

¹⁸Kthim përgjigje me shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2021.

¹⁹Referuar dokumentacionit në dosjen e ILKPKI-së.

ap. 15, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, regjistri hipotekor nr. ***, me nr. pas ***, në pronësi të z. B. H..

23.6. Referuar të dhënave nga “Tirana Bank”²⁰, rezulton se kredia në shumën 20.000 euro (20.00 euro) është disbursuar në datën 14.12.2016, në llogarinë nr. ***, në euro në emër të z. A. C.. Në të njëjtën datë është transferuar në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., shuma 15.000 euro, me përshkrim “likuidim përfundimtar blerje banese”, ndërsa shuma prej 4.800 euro është tërhequr *cash* nga babai i subjektit.

23.7 Kjo kredi është mbyllur në datën 4.3.2013, me një depozitim *cash* të shumës 14.589 euro nga z. A. C., me përshkrimin “shlyerje e parakohshme kredie”. Lidhur me shlyerjen e parakohshme të kredisë në “Tirana Bank”, i është kërkuar subjektit të rivlerësimi të deklarojë burimin e të ardhurave për shumën e depozituar *cash* në datën 4.3.2013.

23.8. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti, ndërmjet të tjera, deklaron se: “Për shlyerjen e saj përpara afatit, pra, datë 4.3.2013, nga deklarimet e dhëna nga babai dhe vëllai në lidhje me këtë pyetje, sqaroj se kanë shërbyer të ardhurat e akumuluar nga puna e vëllait tim nga viti 2001 deri në 2012 dhe bashkëshortes së tij E. C. (B.) prej vitit 2011 dhe deri kur është paguar kredia (të cilat janë administruar në mënyrë të pavarur prej tyre në formë të ndryshme si *cash*, depozita, gjendje në llogari rrjedhëse dhe dhënie hua rrethit familjar të tyre sikundër është sqaruar tek pjesa hyrëse e përshkrimit të pasurive të familjarëve të mi)”.

23.9. Referuar të dhënave nga “OTP Bank” në datën 28.2.2013 është transferuar në llogari rrjedhëse në lekë, në emër të z. A. C., shuma 1.700.000 lekë, nga z. S. B. me përshkrimin “dhënie hua”. Në datën 4.3.2013 është tërhequr shuma 2.100.000 lekë dhe, po në të njëjtën datë, është depozituar *cash* në “Tirana Bank” shuma 14.589 euro, e cila ka shërbyer për shlyerjen përpara afatit të kredisë së marrë në shumën 20.000 euro, me kontratën e datës 4.12.2006.

23.10. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, lidhur me mospërputhje të burimit të deklaruar për shlyerjen përpara afatit të kredisë së marrë në shumën 20.000 euro, në “Tirana Bank” me kontratën e datës 4.12.2006, pasi nga dokumentacioni bankar, duket se ka shërbyer shuma prej 1.700.000 lekësh, transferuar në datën 28.2.2013, në llogari të vëllait të subjektit nga z. S. B. me përshkrimin “dhënie hua”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

23.11. Subjekti, në lidhje me konstatimin e Komisionit, sqaron se: “Ka mospërputhje të burimit të deklaruar për shlyerjen përpara afatit të kredisë së marrë në shumën 20.000 euro, në “Tirana Bank” me kontratë, datë 4.12.2006, pasi nga dokumentacioni bankar duket se ka shërbyer shuma prej 1.700.000 lekësh, transferuar në datën 28.2.2013, në llogari të vëllait të subjektit, nga z. S. B. me përshkrimin “dhënie huaje”, sqaroj si më poshtë:

Shuma e parave për të cilën kërkohen sqarime përbëhet nga shuma e parave prej 1.700.000 lekë e transferuar nga llogaria e vjehrrit të vëllait tim, z. S. B., me përshkrimin “pagesë në favor të A. C. dhënie borxhi” dhe pjesa tjetër shuma prej katërqind mijë lekë nga të ardhurat nga paga e vëllait. Sqaroj se kjo shumë e dhënë nga ana e vjehrrit të tij, nuk është hua, por është në të vërtetë kthimi i shumës së parave që vëllai dhe bashkëshortja e tij i kishin dhënë hua vjehrrit të vëllait.

²⁰Shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2020.

Paraqes në cilësinë e provës të shpjegimeve si më lart, deklaratën noteriale të vjehrrit të vëllait tim, z. S. B., i cili pranon që shuma i është marrë hua vëllait tim, dhe që më pas i është kthyer atij, si dhe deklaratata noteriale të vëllait tim, që pasqyron të njëjtat rrethana”.

23.12. Gjithashtu, subjekti shpjegoi se vëllai nuk kishte përse të merrte hua, kur ai kishte të hapura dy depozita në shumat prej 1.500.000 lekësh dhe 5.000 GBP në vitin 2012, depozita të deklaruara në pyetësonin nr. 2. Fakti që vëllai ka pasur mundësi për të dhënë këtë hua, ka rezultuar e provuar nga vërtetimet e të ardhurave të tij ndër vite.

23.13. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse. Deklarimi i pasaktë i nuk përbën shkak për ngarkimin me përgjegjësi të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë që në analizën financiare janë pasqyruar mundësitë financiare të vëllait të subjektit të rivlerësimit, duke çuar trupin gjykues në konkluzionin se ky deklarim i pasaktë nga subjekti nuk bëhej për të shmangur një situatë negative financiare të tij.

iii) Të ardhurat nga paga e subjektit (apo nga trajtimet të tjera) sipas ligjit, si dhe ato të pjesëtarëve të tjerë të familjes, ndër vite, konkretisht bashkëshortes, djalit dhe vajzave Lutfije dhe E. Celami (kjo e fundit deri në vitin 2010).

23.14. E pyetur nga Komisioni, në lidhje me kontributin e saj në këtë pasuri, në përgjigje të pyetësonit nr. 2, subjekti, ndër të tjera, shpjegon se: *“Deklarimi që paga ime ka qenë burim i krijimit të kësaj pasurie së bashku me të ardhurat e familjarëve të tjerë, lidhet vetëm me faktin që unë me të ardhurat që merrja kontribuoja vetëm në shpenzimet për jetesë, si në shpenzimet e përbashkëta para vitit 2012, ashtu edhe për të hequr shpenzimet e mia pas vitit 2012, dhe nuk lidhet me ndonjë mënyrë apo lloj tjetër kontributi...”,* ndërsa për të ardhurat e pjesëtarëve të tjerë të familjes shpjegon se: *- Ndikimi i këtyre të ardhurave të marra ndër vite në krijimin e kësaj pasurie, është në kuptimin që nëpërmjet këtyre të ardhurave secili prej nesh përfshirë edhe mua ka patur mundësi të kontribujë në shpenzimet e përbashkëta të jetesës, duke mundësuar në këtë mënyrë që të ardhurat e vëllait dhe të babait të ishin të mjaftueshme për të krijuar këtë pasuri”.*

23.15. Në këtë pyetëson, subjekti i rivlerësimit ka pasqyruar një tabelë ku analizohen në kohë dhe vlerë të ardhurat e secilit prej pjesëtarëve të familjes dhe konkretisht: (i) për periudhën 2001 – 2011, të ardhura në total të familjarëve (përfshi edhe subjektin e rivlerësimit), rezultojnë në vlerë totale 28.630.106 lekë; (ii) për periudhën 2012 – 2017, në vlerë totale 24.751.834 lekë. Babai i subjektit, ka deklaruar përveç sa më lart, pasurinë apartament në bashkëpronësi me bashkëshorten edhe pasurinë e luajtshme.

24. Gjendje në llogarinë rrjedhëse në “Credins Bank”, kursime nga paga, vlera 412.326 lekë

24.1. Referuar të dhënave nga “Credins Bank”²¹, rezulton se kjo llogari është hapur në korrik të vitit 2014, në të cilën janë transferuar pagat nga Ministria e Financave. Kjo llogari ka pasur këtë ecuri, deri në deklaratën *Vetting*:

Viti	Vlera në lekë - gjendje 31/12
2014	126.513
2015	225.958
2016	475.326
27.1.2017	413.326

²¹Shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2020.

Referuar analizës financiare trupi gjykues arrin në konkluzionin se nuk konstatohen problematika lidhur me këtë llogari.

25. Lidhur me hetimin e personave të lidhur

25.1. Referuar të dhënave nga Raiffeisen Invest²² rezulton se babai i subjektit, ka investuar në Fondin Prestigj për periudhën prill 2013 – janar 2014, shumën 490.000 lekë. Në datën 11.3.2014, janë shlyer kuotat në shumën *neto* prej 504.812 lekë.

25.2. Nga të dhënat e “Raiffeisen Bank” shuma prej 504.413 lekësh është transferuar në llogarinë e pagës së shtetasit H. C., në datën 17.3.2014 dhe në datën 18.3.2014 është transferuar shuma 500.000 lekë me përfitues znj. F. B. (datëlindjes 6.4.1962), me përshkrimin “kalim në llogari për shlyerje detyrimi”.

25.3. Në lidhje me burimin e të ardhurave të shumës së investuar nga babai në Raiffeisen Inves, si dhe destinacionin e shumës pas tërheqjes nga Fondi Prestigj, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ndër të tjera, deklaroi se: *“Të ardhurat në shumën prej 490.000 lekësh, për Fondin e Investimit krijuar pranë Raiffeisen Prestige, të bërë nga babai im, janë nga të ardhurat, nga punësimi i vëllait tim A. C.. Nisur nga fakti se këto veprime duhej të kryheshin në orarin e punës, sidomos edhe se në bankat kishte radhë, meqenëse babai ishte në pension të parakohshëm ushtaraku (në lirim)dhe kishte kohë fizike si edhe për ta angazhuar, vëllai e ka parë si të arsyeshme që të ardhurat nga paga ti tërheqë vetë ...dhe t’ia japë babait që ti investojë në fondin e investimit në fjalë. Babai i ka derdhur këto para në llogarinë rrjedhëse të tij e më pas i ka kaluar tek fondin...”*.

25.4. Subjekti ka bashkëlidhur në formë tabelore tërheqjet e kryera nga vëllai i saj nga llogaria në “Societe Generale Albania”, për periudhën mars 2013 – dhjetor 2013, si dhe investimet në Raiffeisen Prestige për këtë periudhë.

25.6. Gjithashtu, në vijim subjekti deklaroi se: *“Burimi i këtij investimi është krijuar nga të ardhurat e vëllait, dhe nga deklarimet e dhëna nga babai dhe vëllai këto para janë xhiruar nga fondin për tek llogaria rrjedhëse e babait, dhe ky i fundit sipas porosisë së vëllait dhe bashkëshortes së tij ia ka kaluar ato me transfertë bankare të ëmës së kësaj të fundit, për shpenzime që lidheshin kryesisht me përshtatjen e dhomës së vëllait, pasi familja e vëllait do të bëhej me katër veta”*.

Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë investim.

Konkluzioni për vlerësimin e pasurisë

26. Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të saj.

26.1. Trupi gjykues çmon se pasaktësitë e deklaratimit të gjendjeve *cash* nuk janë në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit, referuar edhe në sa ka rezultuar nga analiza financiare.

26.2. Trupi gjykues vlerëson se në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

²²Shkresë nr. *** prot., datë 4.8.2020.

B. KONTROLLI I FIGURËS

27. Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, DSIK-ja, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin figurës, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur në Komision raportin e deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë 2.11.2020, të KDZH-së, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për subjektin e rivlerësimit. Në vijim ky institucion ka dërguar në datën 17.9.2020 raportin e rishikuar, ku ka konstatuar papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit.

27.1. Komisioni, në lidhje me informacionin e referuar, kreu hetime të thelluara dhe të plota, mbi sa ishte referuar në raportin e organit ligjzbatues.

27.3. Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se: (a) nuk u provua favorizim në procese gjyqësore; (b) nuk vërtetohej, qoftë nga organet ligjzbatuese, ashtu edhe nga hetimi i Komisionit, marrja përsipër për dhënien e ndihmës, kontaktimi i subjektit, kërkimi për të favorizuar një palë ndërgjyqëse dhe dhënia e një vendimi gjyqësor në favor të palës ndërgjyqëse (c) nuk u provua as kryerja e ndonjë veprimi, qoftë edhe në formë tentativash të subjektit, për takime apo marrje përsipër të kryerjes së favoreve me persona të tjerë apo dhe ish-kolegë të saj

Konkluzioni mbi vlerësimin e figurës

27.4. Në këtë drejtim, trupi gjykues vlerëson se edhe shpjegimet e subjektit i gjen objektivisht bindëse dhe, për rrjedhojë, çmon se nuk ka rrethana të provuara që mund ta ngarkojnë me përgjegjësi brenda përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit znj. Lutfije Celami ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

28. Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar raportin profesional bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, dhe pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

ANALIZA E GJETJEVE

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit znj. Lutfije Celami ka aftësi mjaft të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se subjekti identifikon normën ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Rastet e vëzhguara tregojnë se subjekti ka shqyrtuar çështje gjyqësore në fushën civile që lidhen me njohjen e pronës me anë të parashkrimit fitues me pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë me marrëdhëniet e punës që lindin nga emërimi në të drejtën familjare që lidhet me konfliktet bashkëshortore në fushën e së drejtës penale që merr në mbrojtje rendin dhe sigurinë publike për drejtimin e

automjetit në mënyrë të parregullt, me pasurinë e personave fizikë dhe juridikë me anë të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën me kufizimin e lirisë së personit.

Gjyqtarja evidenton rastet, kur për zgjidhjen e çështjes kërkohen njohuri të posaçme me ekspertë në fusha të ndryshme të shkencës dhe teknikës, kur ekzistenca e veprës penale përcaktohet nga leja nga organi kompetent shtetëror, kur dispozita penale është e bardhë dhe për përcaktimin e faktit penal i referohet ligjit të posaçëm .

Gjyqtarja Lutfije Celami ka njohuri për parimet themelore të procesit gjyqësor penal dhe civil, jo vetëm që i përdor gjatë gjykimit, por në arsyetimin e vendimit gjenden raste ku iu referohet parimeve në zbatimin e ligjit si: parimin e veprimit të ligjit në kohë; parimin e prezumimit të pafajësisë; parimin e sigurisë juridike; parimin e përgjithshëm të një dyshimi të arsyeshëm; si dhe parimin e sigurimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Subjekti vlerëson dhe i kushton rëndësi dënimit të të pandehurit me burgim dhe pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi, duke aplikuar nenet 59 dhe 63 të Kodit Penal, për veprën penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, por masa e dënimit është shumë e ulët, duke cenuar parimin kushtetues të proporcionalitetit. Identifikon rastet, kur duhet përdorur gjykimi i posaçëm apo shkurtuar. Gjyqtarja ka përdorur referenca në vendimet unifikuuese të Gjykatës së Lartë, të GJEDNJ-së, të Gjykatës Kushtetuese dhe dispozitave të tyre, duke i cituar ato në fund të faqes.

Nga ana tjetër, ndër tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, janë ankimuar tre vendime, nga të cilat një vendim është cenuar pjesërisht dhe pushuar çështja për interpretim të gabuar të ligjit penal material dhe dy janë lënë në fuqi nga gjykata e apelit dhe në një rast është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Lutfije Celami ka aftësi mjaft të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare, të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Gjyqtarja respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirë organizuar dhe e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve, por në disa raste analiza teorike e fakteve dhe provave dhe ligjit është e tej zgjeruar, duke rritur volumin. Gjyqtarja ka bërë praktikë të arsyetimit të vendimit edhe kompetencën, juridiksionin dhe përbërjen e trupit gjykues megjithëse të pakundërshtuar nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjykata. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, por në dy raste interpretimi i ligjit material (nenin 47 të Kodit Penal), që lidhet me masën e dënimit penal është i ulët. Nga pikëpamja formale në një rast vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal është dhënë “në emër të Republikës” kur kemi të bëjmë me kërkime të palëve në fazën e hetimeve paraprake. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Struktura e vendimeve të saj është e standardizuar, e cila përmban në mënyrë të përgjithshme elementët e kërkuar nga legjislacioni procedural civil dhe penal. Kështu, në pjesën hyrëse të dokumentit 1-3 dhe dosjet 1-5, janë shënuar gjeneralitetet e plota të palëve ndërgjyqse, objekti, akuza e plotë dhe baza ligjore përkatëse.

Pjesa arsyetuese hartohet me gjuhë të thjeshtë dhe me strukturë solide. Në dokumentat 1-3 dhe në dosjet 1-5, arsyetimi është strukturuar me nënpjesë të emëtuara me tituj, me paragrafët uniformë,

por ka raste që paraqiten me tekst të gjatë dhe me citim të plotë të përmbajtjes së normave të ligjit të zbatueshëm dhe analizës së fakteve dhe provave, që rëndojnë qartësinë e tekstit.

Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, tregohet e drejta e ankimit për palët, duke përjashtuar një rast. Dispozitivi hartohet me tekst të qartë dhe të plotë, duke treguar sipas rastit të gjitha disponimet që shoqërojnë vendimin përfundimtar. Subjekti i rivlerësimit i kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme, te të cilat në asnjë rast nuk mungon shkak ligjor. Gjyqtarja ka disponuar edhe me vendime të ndërmjetme të ankimeshme për sigurimin e padisë, si dhe me lëshimin e urdhër ekzekutimit.

Aftësitë organizative

Për aspektin sasior

Sipas pikës 3, germa “g”, të vendimit të ish-KLD-së, gjyqtari i gjykatës së shkallës parë që nuk është i organizuar me skesione, si relator gjykon jo më pak se 200 gjykime çështjes që kanë të bëjnë me krime e kv/penale dhe civile me mosmarrëveshje me palë kundërshtare.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës i janë caktuar 1.270 çështje dhe ka përfunduar 1.193 çështje, duke mbartur vitin e fundit të ushtrimit të detyrës 80 çështje. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, gjyqtarja Lutfije Celami ka përfunduar 1.042 çështje nga të cilat 188 penale themeli, 82 kërkesa penale dhe 24 masa sigurimi, 274 civile themeli dhe 126 familjare, 128 civile të veçanta, 59 urdhër mbrojtje dhe 128 urdhër ekzekutimi ose 588 çështje sipas standardit. Për aspektin sasior pikës 3, germa “g” të vendimit të ish-KLD-së, gjyqtari i gjykatës së shkallës parë që nuk është i organizuar me seksione, si relator gjykon jo më pak se 200 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me krime e kv/penale dhe civile me mosmarrëveshje me palë kundërshtare. Rrjedhimisht, bazuar në të dhënat e mësipërme mesatarja e gjykimit për subjektin Lutfije Celami është 196 çështje penale dhe civile në vit ose nën standardin minimal të caktuar me vendim të KLD-së.

Për aspektin kohor

Sipas pikës 5, germave “a” ,”d” dhe “e” të vendimit të ish-KLD-së, në gjykatën e shkallës parë, krimet gjykohen për 9 muaj, kv/penale për 4 muaj, civile familjare për 4 muaj dhe civile të përgjithshme për 6 muaj. Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Lutfije Celami ka qenë në intervale kohore nga 3 ditë, deri në 5 muaj e 19 ditë. Në tri dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 8 ditë, 3 muaj e 12 ditë dhe 2 muaj. Çështja, që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit, prej 5 muaj e 19 ditë, e cila del edhe tej afatit 4 mujor të gjykimit, ka qenë çështje civile familjare dhe në përfundim është disponuar me vendim themeli, por 3 seanca gjyqësore janë shtyrë për shkak të gjendjes shëndetësore të gjyqtarës dhe mungesës së palës paditur. Ndërsa në tri dokumentet ligjore të prezantuara nga gjyqtarja rezultoi se afati i gjykimit ka qenë 4 muaj e 24 ditë, 8 muaj dhe 5 muaj e 8 ditë. Nga këto vetëm në 1 rast është tejkaluar me 2 muaj, afati 6 mujor i gjykimit.

Lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimeve gjyqësore

Sipas afatit 5 dhe 10 ditor të përcaktuar nga nenet 113 të Kodit të Procedurës Penale dhe 308 të Kodit të Procedurës Civile, nga vëzhgimet e 5 dosjeve të shortuara, rezultoi se arsytimi i vendimeve është kryer në interval kohor nga 1 – 25 ditë. Në rastet e tjera afati i dorëzimit është 5 ditë, 8 ditë,

6 ditë. Ndër 5 dosjet e vëzhguara 2 vendime janë arsyetuar jashtë afatit ligjor të parashikuar në ligjin e posaçëm procedural civil dhe penal, ndërsa tri vendime brenda afatit ligjor.

Aspekti cilësor

Sipas pikës 4 të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, numri i vendimeve të cenuara nuk duhet të kalojë masën 30 % të vendimeve të animuara. Nga ana tjetër, ndër tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, janë ankimuar tri vendime, nga të cilat një vendim është cenuar pjesërisht (shihni dokumenti nr. 1) dhe dy janë lënë në fuqi nga gjykata e apelit dhe në një rast është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Në total nga tri vendime të ankimuara, janë cenuar 1 vendime ose 33 % e tyre, ose mbi standardin mbi 30 % të vendime të cenuara, të përcaktuar nga pika 4 e vendimit të KLD-së. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8.10.2013 – 8.10.2016”, për gjyqtaren Lutfije Celami janë paraqitur tri ankesa në Inspektoratin e KLD-së, por vetëm një ankesë e vitit 2016 është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit është sugjeruar mbajtja e saj në vijim deri në përfundim të gjykimit në gjykatat më të larta.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Lutfije Celami është efektive në punë.

Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Lutfije Celami ka kryer veprimet e nevojshme me qëllim përfundimin në kohë të gjykimit të çështjeve. Pas marrjes së çështjes me short, gjyqtarja ka vënë në lëvizje shpejt përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore dhe njoftimin e palëve brenda afatit 10 ditor të përcaktuar nga neni 333 i Kodit të Procedurës Penale, si dhe neni 155 të Kodit të Procedurës Civile. Në një rast seanca e parë penale është caktuar 3 ditë më pas nga regjistrimi në gjykatë, për rrjedhim, nuk është respektuar afati 10-ditor i caktimit dhe njoftimit të palëve për seancën e parë gjyqësore sipas neni 333 të Kodit të Procedurës Penale, shkaku nuk justifikohet dhe çështja nuk i përket natyrës urgjente. Gjyqtarja ka disponuar me vendim formal për kalimin e çështjes për veprime apo seancë gjyqësore. Ndër 5 çështjet e vëzhguara, 2 prej tyre ka përfunduar me 1 seancë 1 çështje me 5 seanca), 1 çështje me 6 seanca 1 çështje me 7 seanca Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej 20 seanca të zhvilluara prej tij, mesatarisht 4 seanca për çdo çështje. 13 prej këtyre seancave kanë qenë produktive, ndërsa 7 seanca ose 35 % e tyre kanë qenë joproduktive. Pengesë në 7 seanca joproduktive janë bërë: mungesa e gjyqtarës për shkaqe shëndeti në 2 raste; mungesa e të paditurit në 1 rast; në 1 rast mungon prokurori; në 1 rast seanca është e përsëritur dhe nuk kuptohet se për çfarë shkaku, në rast dite pushimi zyrtar, mbrojtësi ka bërë kërkesa e për t'u njohur me çështjen në 1 rast.

Gjyqtarja Lutfije Celami në tërësi respekton afatet ligjore në caktimin e seancave, duke mbajtur në konsideratë edhe shkaku që shtyn seancën gjyqësore. Nga verifikimi i seancave gjyqësore është konstatuar 1 seancë e caktuar në shkelje të afatit 5 ditor të përcaktuar nga neni 201 i Kodit të Procedurës Civile për sigurimin e padisë Në çështjet civile seancat janë caktuar në afate të arsyeshme nga njëra-tjetra.

Seancat gjyqësore në tërësi nuk janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe me regjistrim audio, në funksion të solemnitetit dhe të transparencës së gjykimit dhe shkaqet nuk relatohen për çdo rast. Në çeljen e seancave ka pasur 9 vonesa nga 11 minuta deri në 1 orë e 10 minuta Shkaku kryesor për vonesën citohet gjykimet e mëparshme të gjyqtarës apo sallat e zëna të gjykimit. Vonesa nuk

ka sjellë pasoja për gjykimin e çështjes. Në 1 rast seanca ka filluar 30 minuta para orarit të caktuar e cila ka sjellë si pasojë dështimin e seancën për shkak të mungesës së palës paditur.

Pavarësisht këtyre mangësive, duhet evidentuar se ndër 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, në asnjë rast çështja e gjykuar prej saj nuk është kthyer për rigjykim për shkelje të procedurave gjyqësore.

Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, përgjithsisht është konstatuar se gjyqtarja ka aftësi për të administruar dosjet. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si akti formal i gjyqtarës për kalimin e çështjes në seancë përgatitore apo gjyqësore, në dosje përfshihen kopjet e fletëthirjeve për palët ndërgjyqëse, për të dokumentuar datën e njoftimit për gjykim, procesverbali i seancave, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare të gjyqtarës dhe të zbardhura nga sekretaria gjyqësore, provat, etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Procesverbali gjyqësor plotëson kërkesat e ligjit procedural civil dhe penal, por në 4 raste mungon ora e mbylljes. Në 5 dosjet e vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Etika në punë

Sipas të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtarja Lutfije Celami ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 28.6.2003 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla Magjistraturës në vitin 2011. Pas studimeve, në periudhën tetor 2011 – gusht 2012 ka kryer stazhin profesional në detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në datën 23.1.2014 me Dekret nr. **** të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, ku vazhdon dhe aktualisht.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8.10.2013 – 8.10.2016”, për gjyqtaren Lutfije Celami janë paraqitur 3 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (2 në vitin 2015 dhe 1 ankesë në vitin 2016), nga të cilat një ankesë e vitit 2015 është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se është ankesë e përsëritur. Një ankesë e vitit 2015, verifikuar për zvarritje gjykimi, e cila i është regjistruar gjyqtarës për efekt të vlerësimit profesional dhe etik dhe “tërheqje vëmendje me shkrim”, një ankesë e vitit 2015 është e përsëritur, një ankesë e vitit 2016, verifikuar për mosrespektim formal të ligjit është sugjeruar mbajtja e saj në vijim deri në përfundim të gjykimit në gjykatat më të larta. Për gjyqtaren Lutfije Celami, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton që ndaj saj të ketë ardhur një kërkesë nga Ministria e Drejtësisë për procedim disiplinor.

Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Lutfije Celami dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Për gjyqtaren Lutfije Celami,

në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara, nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin në format letër, është konstatuar se komunikimi ka qenë i qartë dhe i rregullt. Gjuha e përdorur në seancë gjyqësore dhe në akte, në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Lutfije Celami për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Duhet evidentuar se nuk ka pasur seanca gjyqësore të dështuara nga planifikimi për shkaqe të organizimit të trupit gjykues apo stafit administrativ, por 2 prej tyre kanë dështuar për shkak të gjendjes shëndetësore të gjyqtarës. Subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e një trupi gjykues të formuar me 1 gjyqtar dhe me tre gjyqtarë në 1 rast. Në 2 raste është konstatuar vonesë në arsyetimin e vendimit dhe depozitimin e dosjes gjyqësore në sekretari.

Gatishmëria për t'u angazhuar

Gjyqtarja Lutfije Celami i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Sipas nenit 76/5 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", për vlerësimin "shumë mirë" periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 40 ditë në vit dhe jo më shumë se 200 ditë gjatë 5 vjetëve. Për rrjedhim, duke interpretuar shifrat me rendin zbritës, standardi minimal rezulton 28 ditë për 3 vjet. Subjekti i rivlerësimit Lutfije Celami i ka bashkëngjitur formularit të vetëvlerësimit vërtetimin nr. *** prot., datë 25.10.2016, të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës. Sipas këtij vërtetimi, që paraqitet i rregullt nga ana formale, subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në 14 trajnime në 25 ditë për 3 vjet, të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Për rrjedhim, subjekti i rivlerësimit Lutfije Celami nuk ka plotësuar standardin minimal të pjesëmarrjes në formimin vazhdues prej 28 ditësh në 3 vjet, sipas pikës 5, të nenit 76, të ligjit për Statusin. Lënda e trajnimeve ka lidhje me detyrën e gjyqtarës në fushën penale dhe civile.

Konkluzioni për vlerësimin profesional

Trupi gjykues, bazuar në: (i) konstatimet e mësipërme dhe në argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit; dhe (ii) gjetjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016, "Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", konkludon se subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

DENONCIMET

Në Komision janë regjistruar denoncime për subjektin e rivlerësimit, të cilat janë administruar duke i kërkuar subjektit shpjegime lidhur me këto denoncime si vijon:

1. Denoncimet nr. * prot., datë 23.1.2018 dhe nr. *** prot., datë 16.2.2018**

Denoncuesi E. M. pretendon se ka pasur korrupsion, zvarritje të procesit, vendime të kundërligjshme, proces të pabazuar në prova, shkelje procedurale dhe shkelje të etikës profesionale gjatë procesit gjyqësor për kundërvajtjen penale “mosdhënie të mjeteve për jetesë”.

Denoncuesi ka bashkëlidhur kërkesat e tij për përjashtim të gjyqtarës Lutfije Celami, si dhe kërkesën për konstatimin e pavlefshëm të aktit procedural të të dëmtuarës akuzuese dhe pushimin e ndjekjes penale për shkak se viktimat nuk kanë bërë ankim. Gjithashtu ka bashkëlidhur vendimin nr. *** lidhur me kundërvajtjen penale “mosdhënie të mjeteve për jetesë”, vendimin “për ndryshim ose ndërprerje të urdhrit të mbrojtjes” dhe vërtetime nga zyra përmbarimore.

Subjekti, me anë të shpjegimeve, sqaroi se pretendimeve të denoncuesit u ka dhënë zgjidhje në arsyetimin e vendimit përfundimtar nëpërmjet argumenteve ligjore. Këto argumente lidhen jo vetëm me themelin e padisë mbi përmbushjen e rrethanave për ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes, por edhe ka qartësuar paditësin që pretendimet e tij mbi faktin se nuk ka pasur dijeni për gjykimin për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes nuk mund të jenë shkak ligjor për ndryshimin e urdhrit të mbrojtjes, por një shkak ligjor për të pretenduar me mjetin e duhur procedural, rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes.

Në lidhje me pretendimet e denoncuesit E. M. për cenim të etikës profesionale, subjekti paraqiti kopje të CD-ve ku janë regjistruar procesverbalet e seancave gjyqësore të zhvilluara me sistem audio për këto dy çështje.

Gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, trupi gjykues konstatoi se subjekti ka ruajtur etikën gjyqësore në komunikimin me palët duke u dhënë përgjigje pretendimeve të tyre me vendime të ndërmjetme të arsyetuara në seancë.

2. Denoncimi nr. * prot., datë 17.4.2018**

Denoncuesi A. K. ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit për shkelje të ligjit dhe korrupsion duke pretenduar se tokën për të cilën është pronar legjitim, pa të drejtë ia ka kaluar të vëllait të denoncuesit. Denoncuesi ka bashkëlidhur edhe akte nga ZRPP-ja, certifikata pronësie, etj., si dhe vendimin nr. *** regjistri themeltar, me objekt “detyrimin e të paditurit të më njohë pronar”.

Lidhur me këtë denoncim mbas verifikimit të fakteve të denoncimit dhe marrjes së shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se gjatë gjykimit të kësaj çështjeje penale, në seancën e datës 14.11.2016, në fazën e parashtrimit të fakteve dhe të provave nga palët sipas nenit 356 të Kodit të Procedurës Penale, në bazë të nenit 343 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka vendosur pezullimin e gjykimit të kësaj çështjeje deri në zgjidhjen me vendim të formës së prerë të çështjes civile nr. *** akti, datë regjistrimi 10.12.2015, që i përket paditësit A. P., të paditurit Kujtim Tana dhe me objekt: kthimin e fëmijës dhe ushtrimin e përgjegjësisë prindërore me bazë ligjore nenet 218 dhe 220 të Kodit të Familjes, për shkak se vlerësoi se përfundimi i kësaj çështjeje penale varej nga zgjidhja e kësaj mosmarrëveshjeje civile. Ky vendim i ndërmjetëm nuk është ankimuar nga palët duke vijuar në këtë mënyrë i pezulluar gjykimi i kësaj çështjeje deri në paraqitjen e kërkesës së të dëmtuarit akuzues, depozituar më 17.6.2018, për rifillimin e gjykimit për shkak të rënies së shkakut pezullues.

Në vijim, subjekti ka caktuar si seancë gjyqësore për rifillimin e gjykimit të kësaj çështjeje, datën 29.6.2018, ku u njoftuan palët. Për të realizuar njoftimin e rregullt për të akuzuarin K. T., të akuzuarën D. T., si dhe në kushtet kur për disa seanca i akuzuari K. T. kishte paraqitur shkak të ligjshëm për mosparaqitje në seancë, u realizuan disa seanca gjyqësore, deri në njoftimin e rregullt të të akuzuarve në proces²³.

Në lidhje me pretendimet e denoncuesit për zvarritje të gjykimit, pamundësia për të respektuar maksimalisht afatin standard justifikohet nga ekzistenca e shkaqeve procedurale dhe objektive. Shkaqet procedurale lidhen kryesisht me sjelljen e palëve në proces, me pezullimin e gjykimit sipas vendimit të pezullimit, me përpjekjet për të realizuar njoftimin e rregullt të të akuzuarve në proces, me dhënien kohë palës së dëmtuar akuzuese që të parashtronte dhe paraqiste provat në gjykim apo kërkesat e ndryshme që kanë pasur palët gjatë gjykimit, duke mos pasur asnjë shtyrjes për mosformim të trupit gjykues (trupi gjykues verifikoi kopje të CD-së ku janë regjistruar seancat me sistem audio).

Në lidhje me pretendimet e denoncuesit për mungesë të etikës dhe njëanshmëri në këtë proces, trupi gjykues arrin në konkluzionin se këto pretendime të denoncuesit nuk qëndrojnë, pasi ka dëgjuar kopje të CD-së ku është regjistruar procesverbali i seancave gjyqësore të zhvilluara me sistem audio për këtë çështje nga trupi gjykues.

3. Denoncimi nr. * prot., datë 11.9.2018**

Denoncuesi A. P. ankohet për subjektin e rivlerësimit duke pretenduar se ka kryer shkelje të etikës profesionale, njëanshmëri të procesit dhe zvarritje të procesit. Denoncuesi nuk ka identifikuar ndonjë shkelje konkrete për subjektin e rivlerësimit, si dhe nuk ka referuar asnjë akt të lëshuar prej saj apo prova që të vërtetojnë pretendimet e tij.

Denoncuesi A. K. ka qenë në pozitën procedurale të paditësit në çështjen civile me nr. *** regjistri themeltar, me të paditur shtetasit T. dhe B. K. etj., me persona të tretë DAMT Qarku Berat, ZVRPP-ja Skrapar dhe Bashkia Skrapar, me objekt të padisë: “Detyrimin e të paditurit të më njohë pronar për sip. 980 m² e llojit ‘arë’, të ndodhur në ngastrën e quajtur ***, në fshatin ***, Skrapar, sipas përcaktimit në aktin e marrjes së tokës në pronësi; lirimimin dhe dorëzimin e sipërfaqes prej 980 m² e llojit ..., detyrimin e ZVRPP-së Skrapar të regjistrojë pasurinë e mësipërme me sip. 980 m², në emër të familjes bujqësore të Ali Koroni sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi, me bazë ligjore nenin 296 të Kodit Civil”.

²³Theksoj se njoftimi i të pandehurit/akuzuarit për gjykimin që zhvillohet ndaj tij përbën një detyrim për gjykatën dhe është një ndër elementët thelbësor për një proces të rregullt ligjor. Për këtë arsye, një ndër detyrat e gjykatës gjatë veprimeve paraprake është edhe verifikimi i paraqitjes së palëve dhe nëse i pandehuri nuk ka marrë njoftim apo njoftimi është i dyshimtë, urdhërohet përsëritja e njoftimeve (neni 348, 349 dhe 350/4 të Kodit të Procedurës Penale). Rregullat për njoftimin e të pandehurit parashikohen nga neni 139 e vijues i Kodit të Procedurës Penale dhe nëse njoftimi nuk mund të bëhet në bazë të këtyre dispozitave procedurale, atëherë autoriteti procedues urdhëron kërkimin e të pandehurit. Kur kërkimet nuk japin rezultat, nxirret vendimi i mosgjetyes dhe njoftimi bëhet duke i dorëzuar një kopje mbrojtësit.

Në lidhje me njoftimin e të pandehurit në gjykim, GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj dhe konkretisht në çështjen Sejdiviç kundër Italisë shprehet se: “... të njoftosh një person për procedimin penal të nisur në ngarkim të tij përbën një akt juridik të një rëndësie të tillë që duhet tu përgjigjet disa kërkesave formale dhe ligjore të tilla që të jenë të afta për të garantuar një ushtrimin efektiv të drejtave të të pandehurit ashtu siç parashikohen nga neni 6/3/a i KEDNJ-së. Një dijeni e turbullt dhe jo zyrtarë nuk është e mjaftueshme.”

Pra, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së si pjesë integrale e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, që i pandehuri të konsiderohet se është njoftuar në mënyrë efektive, njoftimi sipas legjislacionit tonë të brendshëm duhet të jetë bërë në mënyrat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale dhe duhet të jetë i dokumentuar. Në mungesë të një njoftimi zyrtar nuk mund të thuhet se i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm gjatë gjykimit.

Kjo çështje ka përfunduar me vendimin përfundimtar nr. ***, datë 29.1.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 5.2.2020, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Denoncuesi A. K., si paditës ka pretenduar se është pronari i pasurisë objekt gjykimi dhe ka kërkuar nga i padituri (vëllai i tij, banor i Njësisë Administrative ***, Skrapar) njohjen e tij si pronar dhe lirim dhe dorëzimin e pasurisë objekt gjykimi, kërkim të cilin e ka ngritur në bazë të nenit 296 të Kodit Civil, ku parashikohet padia e kërimit të sendit apo e rivendikimit të sendit. Në përmbushje të barrës së provës që invokon kjo padi në proces, paditësi paraqiti në gjykim një akt të marrjes së tokës në pronësi (pa numër dhe datë), lëshuar në emër të tij ku rezultonte se ishte pajisur me tokë bujqësore e llojit “arë”, gjithsej për tre ngastra, duke përfshirë edhe ngastrën e emërtuar “****” me sip. 980 m² (ngastra objekt gjykimi). Ka rezultuar se ky akt nuk i ka pasur të përcaktuar kufijtë e ngastrave. Nga paditësi për regjistrimin e këtij akti, fillimisht, ka realizuar procedurën në njësinë administrative përkatëse për paraqitjen hartografikisht të këtyre ngastrave dhe, më pas, nga kjo njësi është dërguar dokumentacioni për regjistrim në ZQRPP. Kjo e fundit ka refuzuar regjistrimin e kësaj ngastrë, pasqyruar në aktin e marrjes së tokës në pronësi me argumentimin se krijon mbivendosje me pasurinë e regjistruar më parë në favor të të paditurit në bazë të aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. ***.

Ka rezultuar se edhe i padituri ishte i pajisur me AMTP-në nr. ***, nga i njëjti Komision i Tokës, për tre ngastra, duke i dhënë sipërfaqe edhe në ngastrën ***, me sip. 3750 m². Edhe në aktin e të paditurit nuk kanë qenë të pasqyruara kufizimet për këto ngastra. Ky akt kishte shërbyer për regjistrimin e pasurisë objekt gjykimi, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Rezultoi se i padituri dhe familjarët e tij posedonin aktualisht pasurinë objekt gjykimi mbi bazën e këtij akti.

Subjekti rezulton se ka orientuar paditësin gjatë gjykimit mbi mjetin procedural të realizimit të së drejtës së tij, pala paditëse i qëndron të njëjtit objekt dhe bazës ligjore deri në përfundim të gjykimit.

4. Denoncimi nr. * prot., datë 24.7.2018**

Denoncuesi D. B. ankohet për një grup gjyqtarësh, ndër to edhe për subjektin e rivlerësimit me pretendimin e mosrespektimit të procedurës ligjore. Denoncuesi ka bashkëlidhur me formularin e denoncimit edhe akte të tjera si vendime, aktekspertime etj., por nuk vërtetohet pretendimi lidhur me subjektin e rivlerësimit, pasi aktet në fjalë nuk lidhen me të, por me gjyqtarë të tjerë të përmendur në denoncim.

Denoncuesi D. B. ka qenë në pozitën procedurale të paditësit në çështjen civile me nr. *** regjistri themeltar, datë 30.4.2018, me të paditur Zyra Përmbartimore Berat, banka “Societe Generale Albania”, A. M., ZVRPP-ja Kuçovë, me objekt të padisë: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ vendim nr. *** -gj-prot., datë 2.9.2011, i Zyrës Përmbartimore Berat (vendim kalim pronësie); konstatimin e pavlefshmërisë absolute apo anulimin për sa i përket të gjithë procedurës përmbartimore të zhvilluar për pasurinë tokë arë me sip. 1544 m², të ndodhur në Havaleas Kuçovë ... 3; fshirjen nga regjistri hipotekor me nr..., në emër të A. M. dhe regjistrimin e pasurisë në emër të paditësve”.

Kjo çështje është përfunduar me vendimin përfundimtar nr. ***, datë 17.9.2018 dhe është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 8.7.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Në përmbajtje të denoncimit të tij, shtetasi D. B. ankohet vetëm për mosrespektim të procedurës ligjore në çështjen e dhënë ndaj tij, duke mos specifikuar më konkretisht.

Nga verifikimi i kryer rezulton se në procesin e zhvilluar për këtë çështje subjekti ka respektuar procedurën ligjore në çdo fazë të hetimit gjyqësor, duke zhvilluar një proces të rregullt ligjor dhe një gjykim të drejtë (neni 42 i Kushtetutës dhe neni 4 i Kodit të Procedurës Civile).

5. Denoncim nr. * prot., datë 24.4.2019**

Denoncuesi S. N., në ankimin e tij, pretendon shkelje profesionale nga subjekti i rivlerësimit. Ndër të tjera argumenton se arsyetimi i vendimit nr. ***, datë 27.3.2018, i Gjykatës së Faktit në Berat është konfuzion qëllimor që të jep për të kuptuar se gjykata ka rënë në korrupsion. Denoncuesi ka bashkëlidhur vendimin nr. ***, datë 27.3.2018, për të vërtetuar pretendimet e tij. Problematika e trajtuar në denoncim ka të bëjë me faktin se gjykata, sipas denoncuesit, ka dashur të arsyetojë një kontratë investimi, e cila është shlyer, si një kontratë huaje.

Çështja civile me nr. *** regj themeltar, datë 5.1.2016, me paditës B. Z. me ndërhyrës kryesor shoqëria “****” sh.p.k., me të paditur P. B., me objekt: detyrimin e të paditurit t’i kthejë paditësit shumën 293.000 euro. Shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa në pagimin e detyrimit, të përbërë nga fitimi i munguar dhe kamatat nga lindja e detyrimit deri në ditën e ekzekutimit të vendimit, ka përfunduar me vendimin përfundimtar nr. ***, datë 27.3.2018 dhe është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 9.5.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Subjekti shprehet se ka përfunduar hetimin gjyqësor, e bindur se objekti i gjykimit ishte shqyrtuar me hollësi duke debatuar mbi të gjitha provat që janë pranuar të merren në gjykim, dhe vendimi është mbështetur vetëm mbi fakte që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor (neni 10) dhe vetëm në të dhëna që ndodhen në akte dhe që janë shqyrtuar dhe debatuar në seancë gjyqësore (neni 309/1).

Gjatë gjykimit, subjekti ka orientuar palët mbi barrën e provës në proces të secilit në raport me pretendimet e tyre në gjykim nëpërmjet përcaktimit se cila palë ka detyrimin për të vërtetuar një fakt të caktuar.

Gjatë hetimit gjyqësor u provua krijimi i marrëdhënies juridike të huas, lindur ndërmjet paditësit dhe të paditurit, e ndërsa provat e paraqitura nga i padituri nuk ishin të asaj shkalle për të provuar në gjykim me çfarëdolloj prove faktin se kjo shumë monetare i është kthyer paditësit, qoftë në mjete monetare apo qoftë në pasuri të paluajtshme siç është pretenduar nga i padituri, madje në proces në drejtim të mangësisë së provave të paraqitur nga i padituri për të provuar pretendimin e tij, është provuar edhe fakti se nisur nga përmbajtja e aktmarrëveshjes datë 20.10.2006, nënshkruar ndërmjet një shoqërie ndërtuese dhe të paditurit ka rezultuar se shuma që i padituri ka investuar në këtë ndërtim është marrë kredi dhe jo nga paditësi.

6. Denoncimi nr. * prot., datë 10.6.2019**

Denoncuesi Th. C., në ankesën e tij të dorëzuar edhe pranë KLD-së, pretendon ndaj subjektit të rivlerësimit mosrespektim dhe zbatim të gabuar të ligjit duke referuar vetëm vendimet përkatëse pa i bashkëlidhur ato.

Denoncuesi Th. C. ka qenë në pozitën procedurale të të paditurit/kundërpaditës në çështjen civile me nr. *** regjistri themeltar, datë 28.12.2018 me paditës M. K. (H.)/e kundërpaditur me të paditur: (1) Th. C., (2) Dh. C., ... (16). V. C., me objekt të padisë: “(1) detyrimi i palëve të paditura të njohin pronar të pronës së llojit truall dhe ndërtesë, me sipërfaqe respektivisht 290 m² (truall) dhe 180 m² (banesë), regjistruar në Zyrën e Pasurive të Paluajtshme Berat në z. k. *** me nr.

pasurie 1/150, palën paditëse si dhe të gjithë trashëgimtarët e tjerë ligjore e testamentare të ish pronareve trashëgimtarëve, P., E., V. dhe S. H.; (2) detyrimi i palëve të paditura t'i lirojnë e dorëzojnë palës paditëse, si dhe të gjithë trashëgimtarëve të tjerë ligjorë e testamentare të P., E., V. dhe S. H.), pronën e llojit truall dhe ndërtesë, me sipërfaqe respektivisht 290 m² (truall) dhe 180 m² (banesë), regjistruar në Zyrën e Pasurive të Paluajtshme Berat në z. k. *** me nr. *** pas; (3) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes nr. ***, datë 13.7.1949, sipas së cilës është bërë kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pjesë në sendin objekt gjykimi; (4) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes nr. ***, datë 16.6.1959, sipas së cilës është bërë kalimi i së drejtës së pronësisë mbi sendin objekt gjykimi; (5) detyrimin e ZVRPP-së Berat, të fshijë nga regjistri i pasurive të paluajtshme (çregjistrojë) pasurinë e llojit truall dhe ndërtesë, me sipërfaqe respektivisht 290 m² (truall) dhe 180 m² (banesë), regjistruar në Zyrën e Pasurive të Paluajtshme Berat në z. k. *** me nr. *** pas në emër të palës së paditur dhe të mbyllë kartelën e pasurisë si pasojë e një regjistrimi të pronës me titull absolutisht të pavlefshëm; (6) detyrimin e ZVRPP-së Berat, të regjistrojë pasurinë e llojit truall dhe ndërtesë, me sipërfaqe respektivisht 290 m² (truall) dhe 180 m² (banese), regjistruar në Zyrën e Pasurive të Paluajtshme Berat në z. k. *** me nr. *** pas. në emër të trashëgimtarëve ligjorë e testamentare të P., E., V. dhe S. H., sipas akteve përkatëse. Dhe me objekt të kundërpadisë: Detyrimi i paditëses të kundërpaditur të njohë të paditurin kundërpaditës Dh. C., pronar të një banese të ndodhur në lagjen "****" Berat, e përbërë nga dy dhoma, kuzhinë, korridor, banjë, së bashku me truallin dhe oborrin e saj".

Kjo çështje është përfunduar me vendimin përfundimtar nr. ***, datë 24.9.2018 dhe pas verifikimit në faqen elektronike zyrtare të Gjykatës së Apelit Vlorë ka konstatuar se ky vendim nuk ka marrë formë të prerë pasi çështja është me status përpunim.

Denoncuesi Th. C., në ankesën e tij, pretendon mosrespektim dhe zbatim të gabuar të ligjit, duke pretenduar se padia nuk përmbush kriteret e nenit 296 të Kodit Civil, duke pasur kundërshtime për juridiksionin dhe kompetencën, por pa specifikuar më konkretisht. Po ashtu, denoncuesi pretendon se subjekti ka krijuar normë të re ligjore, duke shpallur të pavlefshëm funksionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Po ashtu, denoncuesi pretendon se gjykata ka pranuar një dokument si të vlefshëm dhe të vërtetë, dokument i shkruar në gjuhën osmanishte të vjetër, duke pretenduar se ish-punonjësja e arkivës së lartë të shtetit që ka përkthyer këtë dokument është deklaruar fajtorë për veprën penale shpërdorim detyre me vendim gjyqësor duke parashtruar se pretendimi i tij në gjykim se ky dokument është i falsifikuar, nuk u pranua në gjykim.

Në disponimin për fshirjen nga regjistrat publikë të pasurisë në emër të të paditurve dhe regjistrimit të saj në emër të paditëses dhe bashkëtrashëgimtarëve të tjerë të trashëgimtarëve Haxhistasa, trupi gjykues konstatoi se subjekti është bazuar te pasoja e pavlefshmërisë së veprimit juridik, për të cilën gjykata duhet të shprehet edhe kryesisht (vendimi unifikues nr. 5, datë 30.10.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë). Gjithashtu, në lidhje me pretendimin se dokumenti - defteri kadastral- mbi të cilin mbështet të drejtën e pronësisë paditësjë, është i falsifikuar, këto pretendime të ngritura në gjykim janë arsyetuar nga subjekti znj. Lutfije Celami në vendimin përfundimtar.

7. Denoncimi nr. * prot., datë 3.7.2018**

Denoncuesi M. B. denoncon disa gjyqtarë, ndër të tjerë, edhe subjektin e rivlerësimit dhe pretendon për shkelje procedurale dhe tjetërsim të fashikullit të dosjes gjyqësore duke referuar se subjekti i rivlerësimit ka hedhur poshtë kërkesat për sigurim padie me vendimin nr. ***, datë

21.9.2016, të cituar nga ankuesi, por ky vendim nuk gjendet i bashkëlidhur me ankimin. Gjithashtu, në ankimin e tij shpjegon se vendimet e ndërmjetme marrin numër akti tjetër po numri i themelit qëndron, ndërkohë që sipas tij vendimet e ndërmjetme kanë pasur numër çështjeje tjetër.

Në këtë çështje, subjekti ka zhvilluar gjithsej tri seanca përgatitore. Seanca e parë është caktuar në datën 14.12.2017 seancë në të cilën u kërkua përjashtimi, i subjektit seanca e dytë është caktuar në datën 22.1.2018 është paraqitur nga pala paditëse kërkesa për marrjen e sigurimit të padisë dhe është shtyrë seanca me qëllim që palës paditëse t'i jepej kohë të paraqiste prova të tjera në mbështetje të kërimit të saj. Seanca e tretë për shqyrtimin e sigurimit të padisë është caktuar në datën 29.1.2018. Në këtë seancë është shpallur dispozitivi mbi rrëzimin e kërimit për sigurimin e padisë, vendimi për rrëzimin e sigurimit të padisë së paditësve është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 17.4.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Subjekti, znj. Lutfije Celami në vijim, ka paraqitur ankim pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat në datën 6.2.2018 për kryerjen prej tyre të veprës penale “fyerje të gjyqtarit”, parashikuar nga nenet 318 dhe 25 të Kodit Penal dhe ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje për shkak të kallëzimit ndaj tyre.

Qëndrimi i Komisionit

Trupi gjykues, pasi analizoi denoncimet e mësipërme sipas ligjit nr. 84/2016 dhe pasi analizoi shpjegimet e dhëna dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit dhe nuk gjeti elementë që përbëjnë dyshime për paaftësi profesionale apo që cenojnë figurën e gjyqtarës.

Komisioni vlerëson të theksojë se bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka kompetencë të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këto në kompetencë të një gjykate më të lartë.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Lutfije Celami:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, në bazë të nenit 51, nenit 58, germa “a”, e pikës 1 dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Lutfije Celami, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjqësor Berat.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, më 25.6.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku